

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Lamtumira e fundit për George Mazonakis, mijëra njerëz këndojnë gjithë natën në lagjen ku u rrit
ADRESA	https://piranjat.al/showbiz/lamtumira-e-fundit-per-george-mazonakis-mijera-njerez-kendojne-gjithe-na-i104034
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 13:13:58 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 13:06:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4f52b37e245eae15711d71c64121c59658ed3e2c0403a859538881b864f7e6a
TEKSTI	6252eab60de477123529895de92bb81bea04b2e6700069ba1f47c7a7256c85a6
PAMJA	12039a0d32c20c50c9351e57143436091058486a13d5ca80a7846fd263deb3df

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	be39129bfa56c1cff5d28275c2af091cdb480d9d1614b1e847f069a84c06f5b1
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0b6439cf09af002acf6ffba878872d12e4fabe601bb852ed9a98adac17b7c4e3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon një rën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/be39129bfa56c1cff5d28275c2af091cdb480d9d1614b1e847f069a84c06f5b1>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: pezulion nga detyra efektivin e reagim pas publikimit të një videoje ku shfaqet policia asnjë në Gjirokastër. Një automjet ka me vlerë gazetari Stafa, vdekje përmes një mesazhi armesh, Berisha: Familia e deklaratat bombë të ish-zëvendëskryeministrit deputetes Zegjine Çau

SHOWBIZ

Lamtumira e fundit për George Mazonakis, mijëra njerëz këndojnë gjithë natën në lagjen ku u rrit

Piranjat Përditësimi i fundit 14 Shtator 2026, 15:06



Mijëra njerëz u mbledhën të dielën në Nikaia për t'i dhënë lamtumirën e fundit George Mazonakis, këngëtarit të njohur grek që u nda nga jeta në moshën 54-vjeçare. Në lagjen ku lindi dhe u rrit, aty ku hodhi hapat e parë drejt ëndrrës për t'u bërë artist, Mazonakis u rikthye për herë të fundit mes njerëzve të tij.

Para Kishës së Trinisë së Shenjtë, rrugët u mbushën me fansa që kishin ardhur jo vetëm nga Athina, por edhe nga qytete të ndryshme të Greqisë. Shumë prej tyre mbërritën disa orë përpara nisjes së vigjiljes, ndërsa të tjerë udhëtuan me autobusë të organizuar posaçërisht për këtë moment.

Vigjilja nisi rreth orës 19:30 dhe vazhdoi gjatë gjithë natës. Por ajo që ndodhi në Nikaia ishte shumë më tepër se një ceremoni lamtumire. Ishte një natë e mbushur me muzikë, kujtime, lot dhe duartrokjet për një artist që për dekada ishte pjesë e jetës së publikut grek. Në vend të heshtjes, Nikaia këndoi.

Nga altoparantët dhe mes turmës u dëgjuan disa prej këngëve më të njohura të Mazonakis, ndërsa mijëra njerëz kënduan së bashku. "Ores Mikres", "Thelo na Gyriso sta Palia" dhe "Eisai to Lathos mou to Teleftaio" ishin vetëm disa prej këngëve që shoqëruan orët e gjata të lamtumirës.

Disa fansa kënduan në rrugë, të tjerë nga ballkonet e apartamenteve përreth kishës. Shumë prej tyre qëndruan për orë të tëra në radhë, vetëm për të hyrë brenda dhe për ta parë për herë të fundit.

Në disa momente, emocionet u bënë aq të forta sa familja e artistit kërkoi që këndimi të ndalej. Për pak çaste, gjithçka heshti. Më pas, këngët nisën sërish, të shoqëruara nga duartrokjet e turmës.

Ishte një pamje që tregonte më shumë se çdo fjalë se çfarë vendi kishte zënë Mazonakis në zemrat e njerëzve. Mes mijëra njerëzve u panë tri breza admiruesish. Ata që e kishin ndjekur që nga fillimet e karrierës së tij, prindërit që kishin kaluar rininë me këngët e tij dhe të rinjtë që, edhe pse kishin lindur shumë vite më vonë, i dinin përmendësh hitet e tij.

Kjo ishte një prej trashëgimive më të mëdha të Mazonakis: aftësia për të kapërcyer brezat dhe për t'u bërë pjesë e historive personale të njerëzve.

Për shumë prej banorëve të Nikaia-s, megjithatë, ai nuk ishte thjesht një yll i madh i muzikës greke. Ishte "djali i tyre", fëmija i lagjes që u largua për të ndjekur ëndrrën dhe që pavarësisht famës, nuk harroi kurrë nga kishte ardhur.

Kisha e Trinisë së Shenjtë kishte një rëndësi të veçantë për të. Ajo ndodhet në lagjen ku Mazonakis kaloi fëmijërinë dhe ku, që i vogël, këndonte himne. Pikërisht aty, dekada më vonë, mijëra njerëz u mbledhën për t'i thënë "lamtumirë".

Gjatë vigjiljes në kishë mbërritën edhe disa prej emrave më të njohur të artit grek, mes tyre Angela Dimitriou, Anna Vissi, Lakis Lazopoulos dhe Zeta Makrypoulia. Shumë prej tyre kishin bashkëpunuar me Mazonakis gjatë karrierës së tij dhe zgjodhën të ishin pranë tij në orët e fundit të lamtumirës publike. Ndërkohë, policia vendosi masa të posaçme për menaxhimin e turmës, ndërsa një ambulancë e EKAB qëndroi gjatë gjithë natës pranë kishës.

Ditën e sotme në orën 13:00 do të mbahet funerali i George Mazonakis në Kishën e Trinisë së Shenjtë në Nikaia. Pas ceremonisë, trupi i këngëtarit do të përcillet drejt Varrezave të Treta të Athinës, ku varrimi do të zhvillohet në një ceremoni private, me pjesëmarrjen e familjarëve dhe miqve të afërt.

Familja ka kërkuar që, në vend të kurorave me lule, ata që dëshirojnë të nderojnë kujtimin e tij të bëjnë donacione për organizatën humanitare Humanity Greece. Kështu, Nikaia do t'i japë sot duartrokitjen e fundit një prej figurave më të dashura të muzikës greke. Një artist që dikur largohej nga klubet e natës pas orëve të gjata të performancës, u përcoll këtë herë nga mijëra njerëz që qëndruan zgjuar deri në agim vetëm për të kënduar me të edhe një herë.

George Mazonakis nuk u përcoll në heshtje. U përcoll me zërat e njerëzve që e deshën, me këngët që lanë gjurmë në jetën e tyre dhe me kujtimet e një karriere që tashmë është pjesë e historisë së muzikës greke.

Ndërkohë, krahas ceremonive të lamtumirës, vijon edhe hetimi për rrethanat e vdekjes së këngëtarit.

Dy mjekët e lidhur me rastin pritet të paraqiten para magjistratit për të dhënë dëshmitë e tyre lidhur me atë që ndodhi në klinikën private në Kolonaki, ku Mazonakis pësoi arrest kardiak gjatë një procedure plazmafereze.

Autoritetet po përpiqen të zbardhin minutë pas minute çfarë ndodhi përpara arrestit kardiak, kush ndodhej në klinikë, çfarë procedurash u kryen dhe cila ishte gjendja e këngëtarit në momentet kritike.

Artikuj te sugjeruar

SHOWBIZ 14 Shtator00:12

[Nicole Kidman tërheq vëmendjen në New York/ Rikthehen spekulimet për ndërhyrje estetike](#)

Nicole Kidman tërhoqi vëmendjen me paraqitjen e saj në një event bamirësie në New York, ku u shfaq me një veshje elegante d...

SHOWBIZ 13 Shtator20:50

[Kapitull i ri për Lady Gaga, Këngëtarja dhe Michael Polansky mirëpresin fëmijën e tyre të parë](#)

Këngëtarja e njohur Lady Gaga ka mirëpritur ardhjen në jetë të fëmijës së saj të parë me të fejuarin...

SHOWBIZ 13 Shtator20:43

[Céline Dion rikthehet në skenë pas 6 vitesh](#)

Céline Dion është rikthyer sërish në skenë në Paris mbrëmjen e së shtunës me datë 12 shtator, p...

SHOWBIZ 13 Shtator19:29

[Divorci i ‘kushton’ shumë shtrenjtë manjatit të videolejërave, ja shuma e parave që duhet t’i paguajë ish-bashkëshortes së tij](#)

1.5 miliardë dollarë është vlera që një manjat i tregut të videolejërave në Korenë e Jugut do të duhet ...

SHOWBIZ 13 Shtator10:18

[Samsung kërkon rrëzimin e padisë 15 milionë dollarëshe të Dua Lipës](#)

Samsung i është kundërpërgjigjur padisë së Dua Lipës, e cila kërkon të paktën 15 milionë dollarë d&e...

SHOWBIZ 13 Shtator09:43

[“Ishte një ndërhyrje delikate dhe e vështirë”, moderatori i njohur pëson goditje në tru, qëndron 12 ditë në spital](#)

Moderatori Bledi Strakosha ka ndarë me ndjekësit e tij një nga periudhat më të vështira të jetës, ai ka kaluar një ...

SHOWBIZ 12 Shtator23:35

[VIDEO/ Celine Dion rikthehet pas gjashtë vitesh, këngëtarja përlotet në skenë](#)

Këngëtarja e njohur kanadeze, Celine Dion, është rikthyer mbrëmjen e kësaj të shtune në skenë, pas një mungese...

SHOWBIZ 12 Shtator23:29

[Super ylli amerikan befason shqiptarët, pozon duke bërë shqiponjën dykrenare](#)

Superylli amerikan Cardi B ka bërë shqiponjën dykrenare shqiptare me duar, në një moment që ka tërhequr vëmendjen e fans...

SHOWBIZ 12 Shtator20:52

[“Isha më e mirë”! Albana Osmani: Me Arbanën s’kemi qenë kurrë shoqe](#)

Në një intervistë për emisionin “Se luan Topi” Albana Osmani ka folur edhe për raportin me Arbana Osmanin. E pyetur mbi ngj...

SHOWBIZ 12 Shtator18:13

[Jennifer Aniston dhe Jim Curtis zbulojnë si nisi romanca e tyre](#)

Jennifer Aniston dhe Jim Curtis po shijojnë prej më shumë se një viti lidhjen e tyre, ndërsa partneri i aktorese ka ndarë disa deta...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 13 Shtator

["Kaos" në fluturimin Australi-Katar/ Dy burra p...](#)

Një incident është regjistruar në bordin e një fluturimi nga Melbourne drejt Dohas, ku dy pasagjerë meshkuj u bënë agre...

AKTUALITET 13 Shtator

["Dil jashtë", u përplas me Edi Ramën për "Terri...](#)

Mes debateve dhe përplasjeve, kështu është zhvilluar mbledhja e kësaj të diele mes kryeministrit Edi Rama dhe komunitetit të...

AKTUALITET 13 Shtator

[Të shtëna me armë pranë një lokali në Greqi, dy...](#)


Shqiptari Alket Rizai, ish-bashkëpunëtor i të shumëkërkuarit grek Vasilis Paleokostas dhe i njohur për arratisjen dy herë m...

INVESTIGIME 31 Maj14:01


[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Reagon Clevio!



Reagon Clevio!



Matilda, Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.